

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES
TRYEZË DISKUTIMI MBI KUADRIN LIGJOR PËR INVESTIMET

Këshilli i Investimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe IFC

Tiranë, 23 maj 2018, 14:30 – 17:00

Mbledhja u moderua nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, me praninë në panel të Zëvendës Ministres së Financës dhe Ekonomisë, znj. Albana Shkurta, Përfaqësuese e IFC në Shqipëri, znj. Laura Qorlaze, ekspertëve të IFC, z. Marc Reichel dhe z. Harald Jedlica. Morën pjesë në mbledhje mbi 60 pjesëmarrës, nga Dhoma/Shoqata Biznesi të huaja dhe vendase, kompani dhe studio konsulence me emër në fushën ligjore dhe tatimore.

I. Hapja e mbledhjes

Mbledhja u hap nga Drejtoresha e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Diana Leka, me një mesazh të shkurtër mirëseadhe për pjesëmarrësit dhe një përshkrim të shkurtër mbi rolin e Sekretariatit. Çështja e informimit dhe konsultimit në kohë të ligjeve është bërë objekt diskutimi në mesin e të gjithë aktorëve (Qeveri, Biznes dhe Donatorë) për disa arsye. Sigurisht, kjo kërkon kohë dhe përpjekje por në të njëjtën kohë është e rëndësishme për të vazhduar procesin e reformës përdërisa luan një rol të rëndësishëm në imazhin e vendit dhe në aftësinë dhe vullnetin e kompanive për të investuar. A nevojitet në të vërtetë të ndryshohet kuadri ligjor duke patur parasysh se çështja e parashikueshmërisë së ligjeve është një nga shqetësimet kryesore të biznesit përsa i përket klimës së investimeve në Shqipëri? Çfarë lloj përpjekjesh dhe përmirësimesh të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të tërhequr më shumë investitorë?

Tema për këtë mbledhje është votuar nga anëtarët e KI në dhjetor 2017, si një çështje për t'u konsideruar për diskutim të mëtejshëm në KI gjatë vitit 2018. Komentet, problematikat dhe gjetjet e ngritura mbi kuadrin ligjor të investimeve gjatë kësaj mbledhje do të merren në konsideratë nga ekspertët e IFC (organizatë me një gamë të gjerë ekspertize në çështje që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor të investimeve) për analizimin e legjislacionit aktual. Në anën tjetër, Sekretariati do të paraqesë në mbledhjen e ardhshme të KI në qershor, një përmbledhje të komenteve të diskutuara në këtë tryezë, së bashku me materiale të tjera pune.

II. Konteksti dhe procesi për një Ligj të Unifikuar të Investimeve

Zëvendës Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Albana Shkurta, u shpreh se puna në fushën e investimeve është veçanërisht e rëndësishme në kuadër të Zonës Ekonomike Rajonale ku investimet përbëjnë një nga shtyllat kryesore në Iniciativën e Ballkanit Perëndimor, krijimi i një zone i cili do të përbëjë për investitorët e huaj një destinacion investimesh për tërheqjen e investimeve i cili do të zhvillojë të gjithë rajonin, jo vetëm një vend të caktuar. Aktualisht, një risi është rishikimi i politikave të investimeve në rajonin tonë, studim i kryer nga UNCTAD. Znj. Shkurta bëri një prezantim të shkurtër të pesë dimensioneve të cilat janë matur dhe krahasuar me fokus edhe vlerësimin për Shqipërisë. Kjo është shumë e rëndësishme për diskutimin e kuadrit të investimeve të cilin qeveria po përpqet të hartojë. Pesë shtyllat në Raportin e UNCTAD janë: a)

Kuadri ligjor specifik për IHD-të, b) Marrëveshjet ndërkombëtare të investimeve, c) Rregullat për biznesin, d) Taksat, e) Politikat për punësimin dhe aftësitë e punës.

III. Kontributi i IFC për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri

Përfaqësuesja e IFC në Shqipëri, znj. Laura Qorlaze u shpreh se diskutimi në këtë tryezë me përfaqësues nga komuniteti i biznesit, ka si objektiv të diskutojë mangësitë dhe boshllëqet e kuadrit ekzistues të investimeve dhe nevojën për të plotësuar boshllëqet dhe për të unifikuar pjesët ekzistuese të legjislacionit në një mënyrë efektive dhe të plotë për të adresuar siç duhet nevojat për investime në rritje dhe rritje ekonomike në Shqipëri. Pavarësisht progresit të bërë, mbeten mangësi të mëdha në mjedisin e biznesit të tilla si barra e madhe rregullatore, kuadri i papërshtatshëm për investime private, përveç kufizimeve të tjera të tilla si informaliteti, etj. Mjedisi shqiptar i biznesit mbetet ende jo tërheqës sipas standardeve globale. Prandaj, harmonizimi më i mirë i politikave të investimeve me standardet e praktikave të mira ndërkombëtare, në veçanti në lidhje me nxitjen dhe tërheqjen e investimeve, hyrjen dhe krijimin, sikurse edhe në ruajtjen dhe mbajtjen e investimeve, si një faktor kyç për integrimin ekonomik dhe tërheqjen e më shumë investimeve dhe me cilësi më të lartë në Shqipëri.

IV. Praktikave më të mira ndërkombëtare për një kuadër bashkëkohor ligjor dhe sfidat për një kuadër bashkëkohor ligjor të investimeve

Z. Marc Reichel, ekspert i IFC, mbajti një prezantim mbi: i) Objektivat e një ligji të mirë të investimeve, ii) Përmbajtja kryesore e një ligji të mirë investimesh, iii) Çfarë do të thotë kjo për Shqipërinë? Pas prezantimit të tij, fjala iu dha diskutimeve nga ana e pjesëmarrësve, veçanërisht në lidhje me objektivin e kuadrit ligjor të investimeve, mekanizmat për zgjidhjen e ankesave, investimet strategjike, etj.

V. Komente nga pjesëmarrësit

Z. Marc Reichel, IFC, pyeti pjesëmarrësit nëse mekanizmat e shtetit për zgjidhjen e ankesave janë të rëndësishme për investitorët, dhe çfarë vlerë të shtuar ato mund të sjellin dhe si duhet të jetë nëse i asiston investitorët.

Z. Përparim Kalo, Kalo & Associates, në rastin e mosmarrëveshjeve midis investitorëve kjo çështje mbulohet në kontratë. Kontrata mund të ofrojë etapa të ndryshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si p.sh. opinion ekspertit, ekspertizë teknike, etj. Në rastin e një mekanizmi për zgjidhjen e një mosmarrëveshje midis shtetit dhe një investitori, si p.sh. licencim, normalisht kjo është gjithashtu pjesë e praktikës. Ka patur raste kur qeveria ka negociuar një mosmarrëveshje përpara se të kalojë në zgjidhje gjyqësore. Gjithmonë do të ketë nevojë për një mekanizëm të veçantë pasi qeveria mund të akuzohet për marrëveshje të fshehta.

Z. Marc Reichel, IFC, u shpreh se kosto mesatare për një rast që kalon në zgjidhje gjyqësore kushton 5-7 mil. dollarë. Duam të shmangim ngritjen e çështjes në gjykatë, në fazën më të hershme, në formën e një anese. Ideja e mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është një zgjidhje e shpejtë në formën e avokatit të biznesit (ombudsman).

Ilir Daci, Optima, u shpreh se nuk përbën problem parashikimi në ligjin e investimeve i neneve që kanë të bëjnë me mekanizmat për zgjidhje e ankesave (IGM). Në praktikë, shpesh tregohet se ndonëse ka ligje që parashikojnë qartë institucionet apo procedurat që duhen ndjekur, problem mbetet zbatimi i tyre nga administrata. Duhet të rritet ndërgjegjësimi i administratës mbi

rëndësinë e parashikimeve ligjore dhe zbatimin e duhur të tyre sipas vullnetit të ligjvënësit dhe për mbrojtjen e interesave të investitorëve. Nëse do të parashikohet një IGM i mirëfilltë, sugjerohet që procedura të jetë e detajuar, ku të përcaktohen qartë roli i çdo hallke administrative për trajtimin e ankesave dhe transparente për të gjithë aktorët e përfshirë. Për këtë arsye kuadri nënligjor duhet të jetë i detajuar dhe i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për keq interpretime.

Genti Beqiri, Baker Tilly, u shpreh se IGM duhet të parashikohet si një mekanizëm brenda Ligjit të Investimit, pavarësisht faktit se kontratat e koncesionit kanë dispozita ligjore për mënyrat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve midis investitorëve dhe shtetit. Gjithashtu, u sugjerua që IGM të jetë pjesë e AIDA-s, duke qenë se kjo e fundit është një agjenci *one-stop shop* për investitorët në Shqipëri. Aktualisht, AIDA nuk është në gjendje të zgjidhë këtë çështje.

Në legjislacionin aktual mungojnë incentivat konkrete të cilat të jenë lehtësisht të zbatueshme në dispozicion të investitorëve dhe pa procedura burokratike administrative. Për shembull, mungon informacion i plotë për investitorët se ku mund të investojnë në pronat publike. Këto të fundit nuk janë në treg.

Turker Sengonul, FLAA, tha se IGM shihet si një mekanizëm interesant. Propozimi për krijimin e tij do të jepte një shtysë institucionale për zgjidhjen e ankesave në fazën e parashikuar, me qëllim që investitorët mos t'i drejtohen ambasadorëve të shteteve të tyre apo Kryeministrit.

Iniciativa për një ligj të ri të investimeve duhet të mbështetet por në të njëjtën kohë është e rëndësishme që vizioni i qeverisë mbi klimën e investimeve të ndahet dhe mbështetet nga të gjithë institucionet dhe administrata. Shqetësimet e investitorëve nuk duhet të konsiderohen si problem i një ministrie apo sektori të vetëm, por i gjithë administratës. Kjo e fundit duhet të mbrojë vizionin për një klimë më të mirë investimesh, me një kuadër të duhur nën-ligjor dhe në linjë me politikën në përgjithësi.

Enida Bezhani, Amcham, u shpreh se nëse një IGM duhet të parashikohet në ligj, duhet të bëhet e qartë procedura dhe institucioni që do të jetë përgjegjës, në mënyrë që të mos krijohen mbivendosje me institucione ekzistuese si Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS). Duhet marrë parasysh edhe trajtimi dhe zgjidhja e ankesave të investitorëve.

Alketa Knuti, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), u shpreh se IGM aktualisht menaxhohet nga MSHMS. Është e vërtetë se ekziston një problem ligjor në lidhje me mënyrën si administrata publike mund të vetë-korrigjohet kur merr masa për akte të gabuara administrative. Momentalisht kjo zbatohet nëpërmjet përdorimit të lehtësirave ligjore, si në rastin e korrigjimit të vlerësimit tatimor nëpërmjet ndjekjes së procedurave të ri-kontrollit. Fillimisht, duhet të konsiderohet zgjidhja e këtij boshllëku ligjor, sesa të krijohet një IGM shtesë që mund të krijojë mbivendosje me institucionet aktuale.

Znj. Albana Shkurta, Zv/Ministra e Financave dhe Ekonomisë, u shpreh se hartimi i një modeli IGM synon të zgjidhë mosmarrëveshje në fazën paraprake dhe jo të krijojë mbivendosje me institucione të tjera. Aktualisht, një model IGM ngjan me strukturën e MSHMS e cila ka krijuar tashmë një përvojë mbi problematikat e biznesit, duke përgatitur një bazë të dhënash që do të shërbejë më pas për analiza dhe ndërhyrje përkatëse.

Alketa Uruçi, Boga & Associates, do të ishte me interes të bëhej i ditur qëndrimi apo plani i qeverisë në lidhje me planin për incentiva në përgjithësi apo për investimet strategjike në veçanti. Në mungesë të tij, konsideratat që mund të parashtrihen për një kuadër të ri ligjor në fushën e investimeve mund të jenë vetëm të përgjithshme. Një ligj i ri investimesh është mirë të jetë, por duhet të jemi të ndërgjegjshëm se një ligj i vetëm nuk mund të zgjidhë të gjitha çështjet. IGM në praktikë mund të mbivendoset me struktura të apelimit administrativ që ekzistojnë aktualisht. Nuk përbën problem nëse këto mekanizma ekzistojnë apo jo, por sa efikase dhe praktike janë.

Z. Marc Reichel, IFC, në përgjigje të pyetjes se përse nevojitet një ligj i ri për investimet shpjegoi se:

- Çdo gjë e re ka një pikënisje dhe ligji i ri sjell një frymë të re që mund të shërbejë si një avantazh konkurrues për Shqipërinë, duke zëvendësuar një ligj të vjetër me një formë dhe përmbajtje më të re.
- Ekzistenca e një IGM iu shërben institucioneve të kenë një ide të qartë të problematikave sistematike dhe zgjidhjeve të tyre sistematike. Jep shumë informacion mbi advokimin e politikave.

Z. Dritan Nako, Antea Cement, në lidhje me vetë-korrigjimin e institucioneve në rastin e vendimeve të gabuara mbi praktikën e investitorëve, u shpreh se ai nuk beson se është një problem i instrumentit. Nëse nuk ka një vullnet institucional, më pas gjendet instrumenti. Ligji i ri i investimeve duhet të shtyjë administratën drejt një vullneti pozitiv për investitorët. Për shembull, mund të specifikohet parimi i miratimit në heshtje të akteve administrative në rastin e çështjeve të procedurave apo lejeve.

Z. Hartmut Jarosch, DIHA, vlerësoi përgatitjen e një ligji të ri, sikurse edhe krijimin e një modeli IGM. Por djalli fshihet në detaje dhe administrata merret me detajet. Për këtë arsye, kuadri nënligjor duhet të jetë i detajuar dhe i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për keq interpretime. Është e rëndësishme që mentaliteti i administratës të ndryshojë.

Z. Marc Reichel, IFC, u shpreh se ligji i investimeve është një mundësi për qeverinë për të treguar që ata janë miqësorë ndaj investimeve dhe se janë të gatshëm të ndryshojnë klimën e investimeve. Investitorët duhet të bëjnë presion mbi qeverinë dhe të tregojnë pritshmëritë e tyre nga ky ligj. Në lidhje me parimin e ‘miratimit në heshtje,’ kjo mund të zbatohet për çështje të veçanta të cilat nuk kanë të bëjnë me sigurinë e njerëzve. Për raste të veçanta të cilat kanë të bëjnë me shëndetin dhe mjedisin, nevojitet një miratim. Për ato raste kur nuk merret asnjë përgjigje, IGM është një mekanizëm i mirë ku investitorët mund të kërkojnë një përgjigje apo kur është marrë një vendim negativ për të diskutuar arsyen/arsyet dhe si të bëhen përmirësime.

Z. Harald Jedlicka, IFC, diskutimi për mekanizma të tillë dhe për mënyrat si vihen në përdorim është i përhapur gjithashtu në vende të tjera. Nuk është e mundur të kopjohet një model dhe ta sjellësh atë në një vend tjetër. Ky ligj i ri i investimeve është një mundësi e artë për të ankoruar këtë mekanizëm në një legjislacion por është e nevojshme të punohet në legjislacione të tjera rreth tij. Është e rëndësishme që ka filluar ky diskutim. Duket se ka një konsensus të gjerë që nevojitet një mekanizëm dhe se ka shumë pyetje për mënyrën e funksionimit të tij. Kjo do të përpunohet nga grupi i punës dhe persona të tjerë në këtë tryezë. Investitorët kanë nevojë për më shumë mbrojtje dhe parashikueshmëri në kuadrin ligjor.

Z. Bledar Mankolla, Forscher, në lidhje me IGM, ai mendon se thjesht do të shtohet vetëm një institucion tjetër. Ligji aktual i investimeve krahasuar me legjislacionin aktual të biznesit ofron një element shtesë që ka lidhje me mbrojtjen e investimeve të huaja. Mund të ndryshojmë një ligj jo sepse është vjetëruar, por sepse ka patur problem në vetvete dhe në zbatimin e tij. Këto probleme nuk janë listuar. Një ligj i ri dhe i mirë investimesh nuk mund të përfshijë të gjitha çështjet në një paketë të vetme. Ndonëse investitorët mund të gjejnë në vend një ligj të mirë investimesh, pas këtij ligji fshihet një legjislacion i cili përmban probleme.

Fjoralba Caka, AA+, ngrejti pyetjen nëse është analizuar kuadri i incentivave dhe nëse është në harmoni me *EU acquis*, për të shmangur raste si ato të Hungarisë dhe Polonisë ku incentivat kombëtare u hodhën poshtë nga BE pasi shkëlqin parimet e BE në lidhje me mbrojtjen e konkurrencës.

Z. Marc Reichel, IFC, u shpreh se ligji i ri nuk ka si qëllim të ofrojë incentiva tatimore apo fiskale, dhe grupi i punës nuk ka bërë një analizë nëse incentivat aktuale (si p.sh. në legjislacionin tatimor dhe në legjislacionin e zonave të lira ekonomike) janë në linjë me parimet e OBT dhe BE. Aktualisht, ka incentiva për investimet strategjike, dhe ka shumë të ngjarë që në ligjin e ri nuk do të ketë incentiva fiskale pasi aktualisht nuk ka incentiva fiskale për investimet strategjike. Ka disa klauzola/parashikime të cilat thonë se incentivat e reja duhet të shikojnë këto pika. Përpara miratimit, është e nevojshme një vlerësim se si do të ishte impakti në tërheqjen e investitorëve por gjithashtu edhe në të ardhurat e shtetit. Një nga pikat është të jetë në linjë me rregullat e BE-së.

Z. Dritan Nako, Antea Cement, u shpreh se Ligji i Investimeve Strategjike lë shumë diskrecion tek administrata për të përcaktuar se cili do të konsiderohet një investim strategjik dhe cili jo. A ka si qëllim ligji i ri i investimeve të mbulojë të drejtat e investitorëve të rinj apo ekzistues?

Znj. Albana Shkurta, Zv/Ministre e Financave dhe Ekonomisë, tha se në të vërtetë, kuadri ligjor për investimet strategjike është shumë i detajuar. Kriteret janë specifikuar nga sektori dhe sipas procedurave, të asistuar apo të veçanta, dhe janë të qarta dhe të bazuara në vendimmarrjen e Komitetit të Investimeve Strategjike në AIDA.

Z. Marc Reichel, IFC, u shpreh se ligji i ri i investimeve do të reflektojë mbrojtjen e investitorëve të rinj dhe ekzistues, të zbatueshëm për të dyja kategoritë.

VI. Mbyllja e mbledhjes

Znj. Albana Shkurta, Zv/Ministre e Financave dhe Ekonomisë, falenderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe i ftoi ata të dërgojnë komente dhe ide të tjera pranë Sekretariatit të Këshillit të Investimeve.

Lista e Pjesëmarrësve

<i>Nr.</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Institucion/Organizatë</i>	<i>Emri</i>	<i>Pozicioni</i>
1	Shoqatë	Bashkimi Tregtar i Shqipërisë	Mira Pogaci	Drejtoreshë Ekzekutive
2	Shoqatë	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA)	Turker Sengonul	Zv/President
3	Shoqatë	Foreign Investors Association in Albania (FIAA)	Marinela Jazoj	Drejtoreshë Ekzekutive
4	Shoqatë	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Brunilda Kostare	Këshilltreshë Ligjore
5	Shoqatë	AITA	Dritan Mezini	Kryetar Bordi
6	Shoqatë	Qendra për Rregullimin dhe Ruajtjen e Energjisë - ACERC	Lorenc Gordani	Drejtor Ekzekutiv
7	Shoqatë	Nordic Association Albania	Anjeza Alia	Drejtor Ekzekutiv
8	Dhomë	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)	Mark Crawford	President
9	Dhomë	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)	Enida Bezhani	Drejtoreshë Ekzekutive
10	Dhomë	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)	Dael Dervishi	Anëtar Bordi
11	Dhomë	Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri	Alda Bakiri	Sekretar i Përgjithshëm
12	Dhomë	Dhoma Turke e Tregtisë (ATTSO)	Erinda Zhupani	Sekretar i Përgjithshëm
13	Dhomë	Dhoma Gjermane e Tregtisë (DIHA)	Hartmut Jarosch	Drejtor
14	Dhomë	Dhoma Gjermane e Tregtisë (DIHA)	Marjeta Kodra	Konsulent Biznesi
15	Dhomë	Advantage Austria	Marlinda Zotaj	Drejtoreshë Zyre
16	Dhomë	UCCIAL	Majlinda Manushi	Sekretar i Përgjithshëm
17	Dhomë	CCI Tirana	Albana Laknori	Sekretar i Përgjithshëm
18	Dhomë	CCI Tirana	Fabiola Duro	Këshilltar
19	Biznes	TAP Albania	Eniada Çupi	Ekonomiste
20	Biznes	Balfin Group	Bora Sinani	
21	Biznes	Antea Cement Sh.A	Dritan Nako	Menaxher Administratë & për Marrëdhëniet me Jashtë
22	Biznes	Antea Cement Sh.A	Adrion Qirjazo	Drejtor Finance
23	Biznes	Alpha Bank	Esmeralda Gjoshe	Departamenti Ligjor
24	Biznes	Alpha Bank	Eduart Lekgjika	Senior Dealer, Thesari
25	Biznes	British American Tobacco		Regional Manager
26	Biznes	Bankers Petroleum	Doina Goga	Supervizore ligjore
27	Biznes	Bankers Petroleum	Eriseld Zgjana	Koordinator Shitjesh
28	Biznes	Shell Upstream Albania	Rohan D'Souza	Kryetar
29	Biznes	Colliers Albania	Stela Dhani	Menaxher i Përgjithshëm
30	Biznes	Colliers Albania	Manjola Çondi	Senior Associate
31	Biznes	Vodafone Albania	Artur Tomini	Drejtor Finance
32	Biznes	Vodafone Albania	Ilir Limaj	Këshilltar për Çështjet Rregullatore

33	Biznes	ABCom	Ylli Pulja	Menaxher Cilësie
34	Biznes	FORSCHER	Bledar Mankollari	Menaxher i Përgjithshëm
35	Biznes	Pedersen & Partners	Pranvera Papamihali	Menaxhere e Përgjithshme
36	Donator	IFC	Laura Qorlaze	Përfaqësuese
37	Donator	IFC	Marc Reichel	Ekspert
38	Donator	IFC	Blerte Kraja	Eksperte
39	Donator	World Bank	Harald Jedlicka	Oficer Senior për Politikë dhe Nxitjen e Investimeve
40	Donator	IFC	Keler Gjika	Specialist Sek Financiar
41	Donator	EBRD-Advice for Small Businesses	Neritan Mullaj	Menaxher
42	Donator	EBRD	Endrita Xhaferaj	Eksperte
43	Ambasadë-Agjenci	ICE – Italian Trade & Investment Agency	Elisa Scelsa	Drejtoreshë
44	Ambasadë-Agjenci	ICE – Italian Trade & Investment Agency	Manjola Mumajesi	Analiste Tregtie
45	Qeveri	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Albana Shkurta	Zv/Ministre
46	Qeveri	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Anduena Hoxha	Drejtoreshë
47	Qeveri	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Majlinda Hafizi	Drejtoreshë
48	Qeveri	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zarina Taja	Shefe Sektorit
49	Qeveri	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zamira Xhepa	
50	Qeveri	Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjen	Alketa Knuti	Shefe Kabineti
51	Qeveri	AIDA	Genc Çeli	Drejtor për IHD-të
52	Qeveri	AMF	Niko Kotonika	Drejtor
53	Firmë ligjore	Kalo & Associates	Përparim Kalo	Partner Drejtues
54	Firmë ligjore	AA+ Partners (ligjore & konsulencë)	Fjoralba Caka	Avokate
55	Firmë ligjore	Hoxha, Memi, Hoxha	Ilir Johollari	Avokat
56	Firmë ligjore	Boga & Associates	Alketa Uruçi	Avokate
57	Firmë ligjore	Baker Tilly	Genti Beqiri	Drejtor
58	Firmë ligjore	Optima	Ilir Daci	Partner
59	Firmë Konsulencë për në fushën e Tatimeve & Auditit	Mazars	Teit Gjini	Auditore
60		Sekretariati i Këshillit të Investimeve	Diana Leka	Drejtoreshë
61		Sekretariati i Këshillit të Investimeve	Elvis Zerva	Ekspert Ligjor